

Prishtinë,  
01.12.2020

Për: Kujtim GREIÇEVCI, i/e punësuar në Byronë Kosovare të Sigurimit  
Lënda: Njoftim për mosvazhdimin e kontratës së punës

I/E nderuar znj/z. GRAIÇEVCI,

Në bazë të nenit 28, shkronja b) e Statutit të Byrosë Kosovare të Sigurimit dhe nenit 71, par. 2 i Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, u.d. Drejtori Ekzekutiv i Byrosë Kosovare të Sigurimit lëshon këtë:

### NJOFTIM

për mosvazhdimin e marrëdhënies së punës të punësuarit/es Kujtim GREIÇEVCI.

Për ushtrimin e veprimtarisë së Byrosë Kosovare të Sigurimit në bazë të Ligjit Nr. 04/L – 018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, është vlerësuar se marrëdhënia e punës e deritanishme nuk do të vazhdohet pas skadimit të kontratës së punës në fuqi, e vlefshme deri me date 31.12.2020.


Ky njoftim, bëhet në bazë të dispozitës ligjore të nenit 71, par. 2 të Ligjit Nr. 03/L – 212 i Punës, me të cilin përcaktohet se “Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim të ripërtërijë kontratën me periudhë të caktuar duhet të informojë punësuarin së paku tridhjetë (30) ditë para skadimit të kontratës”, i cili detyrim konsiderohet i përmbushur me dërgimin e këtij njoftimi.

Lidhur me sa më sipër, në rast se gjatë muajit Dhjetor 2020 punëdhënësi Byroja Kosovare e Sigurimit do të vlerësojë si të nevojshme, do t’iu ofrojë kontratën e punës për periudhën e caktuar nga data 01.01.2021. Në rast të ofrimit të kontratës së punës për nënshkrim nga punëdhënësi dhe mospranimit eventual të kushteve dhe nënshkrimit të kontratës së punës, konsiderohet se keni hequr dorë nga lidhja e marrëdhënies së punës dhe ky njoftim për mosvazhdim të kontratës, mbetet në fuqi.

Në rast se nga evidenca e punëdhënësit vërtetohet se keni ditë të pashfrytëzuara të pushimit vjetor për vitin 2020 dhe nuk nënshkruhet kontratë e re e punës, të njëjtat do t’iu kompensohen në bazë të nenit 32, par. 5 të Ligjit Nr. 03/L – 212 i Punës, me të cilin përcaktohet se “Ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor nuk mund të kompensohen me para, përjashtimisht kjo mund të bëhet kur marrëdhënia e punës i skadon të punësuarit”.

Në secilin rast, Byroja Kosovare e Sigurimit ju falenderon shumë për kontributin tuaj të dhënë ndër vite.

Me respekt,

  
Sami Mazreku  
u.d. Drejtor Ekzekutiv





BYROJA KOSOVARE E SIGURIMIT - BKS  
KOSOVSKI URED OSIGURANJA - KUO  
KOSOVO INSURANCE BUREAU - KIB  
Nr. 598/19 Dt. 31.05.2019  
PRISHTINE

Prishtinë, 31/05/2019

Në bazë të nenit 9 të Statutit të Byrosë Kosovare të Sigurimit, Asambleja e Përgjithshme merr kete:

#### V E N D I M

- I. Kontrata e punës e të punësuarit z.Kujtim Greiçevci ne pozitën Auditor i Brendshëm vazhdohet deri me 31.12.2019.
- II. **z.Kujtim Greiçevcit** ne pozitën e lartëcekur, kushtet e kontratës së punes do të mbeten të njejta.
- III. Autorizohet Drejtori Ekzekutiv të nënshkruaj Kontratën e Punës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi, sot më datë 31.05.2019.

#### A R S Y E T I M

Duke qenë se kontrata e punës aktuale e të punësuarit z.Greiçevcit në Byronë Kosovare të Sigurimit do të skadojë me datë 30.06.2019, Asambleja e Pergjithshme mori vendim qe te vazhdohet kontrata e te punesuarit deri me date 31.12.2019. Per kete vendim votuan ne menyre elektronike(email) shtate (7) kompani (Elsig, Sigal, Kosova e Re, Illyria, Scardian, Sigma, Siguria). Kater(4) kompani nuk votuan, andaj edhe u vendos si ne dizpozitiv te ketij vendimi.



**Agim Elshani**

**Kryesues i Asamblesë së Përgjithshme në BKS**